# KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PËR TREGTUESIT E NAFTËS DHE GAZIT

**I. Mbulimi në sigurim**

Shoqëria e sigurimeve "ANSIG" sha (që këtu më poshtë do te quhet siguruesi),në përputhje me këto kushte, kufijtë e mbulimit në sigurim të përcaktuar në formular, do të jetë ligjërisht përgjegjëse të dëmshpërblejë të siguruarin për periudhën e përcaktuar në formularin e kësaj police të sigurimit dhe kundrejt pagesës së primit të sigurimit nga i siguruari sipas përcaktimeve në këtë formular:

1. për shumat për të cilat i siguruari do të jetë ligjërisht përgjegjës të paguajë si kompensim dëmi kundrejt palës së dëmtuar dhe shpenzime të tjera që rezultojnë nga ngjarja e sigurimit për të cilën është e zbatueshme kjo policë e sigurimit, brenda kufijve të përgjegjësisë të përcaktuara në formular.
2. për shpenzimet e mbrojtjes ligjore të kryera me miratimin paraprak me shkrim të siguruesit, në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim ndaj të siguruarit, për të cilën zbatohen kushtet e kësaj police të sigurimit.

**II. Objekti i sigurimit**

1. I siguruari i përcaktuar në formularin e kësaj police të sigurimit është operatori i veprimtarisë së depozitimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.Persona shtesë të siguruar janë:

a. përfaqësuesit ligjorë të të siguruarit dhe personat që ai ka punësuar për të administruar dhe mbikëqyrur veprimtarinë e të siguruarit, apo pjesë të saj;

b. të gjithë punonjësit e tjerë të shoqërisë për dëmet ndaj palëve të treta që shkaktohen si rezultat i kryerjes së e detyrave të tyre në funksion të të siguruarit.

2. Kjo policë sigurimi mbulon:

a. përgjegjësinë ligjore të të siguruarit si pronar, rentier, qeraxhi, përdorues i ambienteve (me përjashtim të fushave të aviacionit dhe aeroporteve), që përdoren vetëm për qëllimet e veprimtarisë së të siguruarit;

b. përgjegjësinë ligjore të të siguruarit si operator (pronar/zbatues) i veprimtarisë së depozitimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

c. përgjegjësinë ligjore të personave përgjegjës sipas kontratës së punës për administrim, pastrim, ndriçim, mirëmbajtje, apo funksioneve të tjera, për dëmet që mund të shkaktojnë gjatë kryerjes së këtyre detyrave.

**III. Ngjarja e Sigurimit**

Kjo policë e sigurimit do të mbulojë përgjegjësinë ligjore të të siguruarit në lidhje me dëmet e mëposhtme që u shkaktohen palëve të treta nga ngjarja e sigurimit e ndodhur gjatë periudhës së sigurimit të përcaktuar në formularin e policës dhe që përfshin:

1. Dëmtimet trupore: vdekja, plagosja, humbja e aftësisë për punë, të një ose disa personave;
2. Dëmet pasurore: dëmi fizik ose shkatërrimi i pasurisë së prekshme që nuk është në pronësi ose posedim të të siguruarit.

**IV. Kufijtë e përgjegjësisë së siguruesit**

1. Përgjegjësia e siguruesit për kostot e kompensimit dhe shpenzimet e pagueshme kundrejt një ose disa të dëmtuarve si rrjedhojë e një ngjarjeje sigurimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si kufi i mbulimit në sigurim për çdo ngjarje.

Të gjitha dëmet që janë pasojë e ekspozimit të vijueshëm, ose të përsëritur të të njëjtave kushte dëmtuese të të njëjtës ngjarje në të cilën ka ndodhur dëmi i parë, do të konsiderohen një ngjarje e vetme.

2. Përgjegjësia e siguruesit për të gjithë kostot e kompensimit dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e sigurimit që ndodhin gjatë një periudhe sigurimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si kufi agregat.
3. Kufijtë e mbulimit të përcaktuar në formular nuk mund të jenë më të ulët se ata të përcaktuar në seksionin X të këtyre kushteve.

**V. Kufijtë territorialë / Juridiksioni**

Territori i Policës nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo policë vepron nën ligjin / juridiksionin Shqiptar.

**VI. Përjashtime,** Kjo policë <u>nuk mbulon</u>:

1. përgjegjësinë që lidhet me dëmtimet shëndetësore, plagosjet apo sëmundjet e palëve që kanë një kontratë pune, ose praktike mësimore me të siguruarin, e personave të punësuar nga i siguruari, në rastin kur dëmtimi shëndetësor, plagosja apo sëmundja vjen si rrjedhojë e zbatimit të kontratës se punës, kontratës mësimore, apo punësimit të tyre.
2. dëmtimet trupore ose dëmet pasurore që shkaktohen nga lëndë ose materiale të prodhuara, ndërtuara, ndryshuara, shërbyera, trajtuara, shitura, furnizuara apo shpërndara nga i siguruari (përgjegjësia e produktit), që nga çasti që këto nuk janë më në posedimin apo nën kontrollin e të siguruarit.
3. përgjegjësinë nga përdorimi i mjetit motorrik që është objekt i sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë motorrike sipas legjislacionit në fuqi, në rast se ky mjet motorrik është në pronësi të të siguruarit, merret me qera, merret borxh, merret me leasing, apo përdoret nga i siguruari, apo nga personi që kërkon dëmshpërblim;
4. përgjegjësinë e anijeve apo avionëve, në rast se ato janë në pronësi, merren me qera, merren borxh, merren me leasing, apo përdoren nga i siguruari;
5. përgjegjësinë për humbjet financiare që nuk janë rrjedhim i dëmtimeve të pronës, apo dëmtimeve shëndetësore të përcaktuara në seksionin II të këtyre kushteve.
6. çdo përgjegjësi të cfarëdo natyre të shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, apo të ndikuar nga ndotja e ajrit, ujit dhe dheut.
7. përgjegjësinë për dëmet dhe dëmtimet e pronës

a. që i përkasin të siguruarit

b. që ndërtohet apo është nën kujdesin, ruajtjen, apo kontrollin e të siguruarit apo të personave të punësuar, apo që punojnë për llogari të të siguruarit.

8. kërkesat për dëmshpërblim për vonesat në respektimin e detyrimeve dhe kompensimet që lidhen me zbatimin e kontratave të ndryshme nga kjo policë e sigurimit.
9. përgjegjësinë që lidhet me ngjarje që rezultojnë nga veprime, ose mosveprime të qëllimshme apo të pandershme të të siguruarit.
10. përgjegjësitë e marra përsipër nga i siguruari nëpërmjet kontratave ose marrëveshjeve të tjera, garancitë e dhëna nga i siguruari që rritin përgjegjësinë ligjore të të siguruarit, përveç, rasteve kur i siguruari do të ishte përgjegjës edhe në mungesë të këtyre kontratave, marrëveshjeve apo garancive.

a. rrezatimi jonizues apo ndotja radioaktive nga lëndë bërthamore ose mbetje bërthamore;

b. vetitë radioaktive, helmuese, shpërthyese ose veti të tjera të dëmshme të materialeve, ose përbërësve bërthamor

12. përgjegjësitë që rezultojnë nga asbesti ose sëmundje të lidhura me të (përfshirë kancerin), që janë pasojë e ekzistencës, prodhimit, trajtimit, përpunimit, shitjes, shpërndarjes, magazinimit ose përdorimit të asbestit, prodhimeve të azbestit dhe/ose prodhimeve që përmbajnë asbest.
13. përgjegjësinë për pasojat e luftës, aktit të pushtimit nga armiq të huaj (pavarësisht nëse lufta deklarohet, ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, grushtit të shtetit, forcës ushtarake, terrorizmit, vandalizmit, akteve keqdashëse, apo sabotazhit.
14. dëmet nga gjobat, penalitetet, masat korrektuese që nuk lidhen me këtë policë sigurimi.
15. dëmet që janë rrjedhojë e moszbatimit të rregullave për ruajtjen e materialeve të djegshëm apo eksplozivë;
16. dëmet që rrjedhin nga aktivitete që nuk parashikohen në mënyrë të veçantë në mbulimet e kësaj police, veçanërisht që vine nga:

a. aktivitete, apo marrëdhënie ligjore që nuk kane të bëjnë me veprimtarinë e të siguruarit dhe as me rrezikun e siguruar.

b. prodhimi, përpunimi, transportimi ruajtja e eksplozivëve për çdo qëllim.

c. pronësia apo përdorimi i hekurudhave për të transportuar mallra / lëndë në ambientin e punës.

**VII. Parashikime të tjera.**

1. Nuk mbulohet përgjegjësia ligjore e operatorëve, përveç atyre të përcaktuar në seksionin II të këtyre kushteve.
2. Detyrimi i siguruesit për dëmshpërblim kufizohet në përqindjen e pjesës së të siguruarit në grupin e ndërrmarjes së përbashkët, pavarësisht se të cilës shoqëri partnere janë personat, apo pronat përgjegjëse për shkaktimin e dëmit.
3. Dëmet që u shkaktohen sendeve të sjella nga partnerët në ndërrmarjen e përbashkët me të siguruarin përjashtohen nga ky mbulim në sigurim, pavarësisht nga fakti se kush është përgjegjës për dëmin.
4. Dëmet që i shkaktohen një partneri të ndërrmarjes së përbashkët nga partnerë të tjerë të ndërrmarjes, apo anasjelltas, përjashtohen nga ky mbulim në sigurim

**VIII. Detyrime të palëve në police**

1. I siguruari duhet të ndërmarrë të gjithe hapat e nevojshëm për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve shëndetësore, apo demtimeve të tjera që mund të çojnë në kërkesa për dëmshpërblim sipas kushteve të kësaj police të sigurimit.
2. Çdo ngjarje që mund të çojë në kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj police të sigurimit, duhet të raportohet me shkrim nga i siguruari tek siguruesi menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Brenda mundësive, nuk duhet të kryhet asnjë lëvizje apo riparim deri sa siguruesi të mund të kryejë investigimin. I siguruari duhet të njoftojë siguruesin menjëherë për çdo proces të mundshëm penal apo civil që lidhet me ngjarjen dhe duhet t'i dërgojë atij menjëherë të gjithë dokumentat përkatëse.
3. Asnjë pranim i përgjegjësisë, premtim për ofertë, apo pagesë nuk duhet bërë pa miratimin me shkrim nga siguruesi. Siguruesi do të ketë të drejtën të marrë përsipër dhe të kryejë në emër të të siguruarit mbrojtjen, ose pagesën e çdo dëmi që rezulton nga ngjarja e siguruar dhe të ndjekë në rrugë ligjore kërkesën për subrogim nga persona të tjerë. I siguruari duhet të japë të gjithë informacionin dhe asistencën që i kërkohet nga siguruesi.
4. Siguruesi mund të paguajë shumën maksimale të pagueshme për ngjarje e sigurimit që mbulohet nga polica e sigurimit, ose një shumë më të vogël me të cilën mund të mbulohen dëmi, apo dëmet që rezultojnë nga ngjarja e siguruar. Siguruesi nuk ka përgjegjësi të mëtejshme për ngjarjen e siguruar, përveç pagesës së kostove dhe shpenzimeve gjyqësore të ndodhura përpara pagesës që mbulon dëmet që rezultojnë nga ngjarja e sigurimit.
5. Në rast se në kohën e ndodhjes së ngjarjes, apo dëmit ka edhe ndonjë policë tjetër të sigurimit të përgjegjësisë në favor, apo për llogari të të siguruarit dhe që zbatohet për këtë ngjarje, siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për dëmshpërblimin e të siguruarit, përveç ndonjë teprice mbi shumën që do të paguhej nga polica tjetër e sigurimit.

**IX. Parashikime të përgjithshme**

1. Këto kushte, çdo shtojcë bashkëngjitur, formulari dhe pyetësori do të lexohen së bashku si një policë dhe çdo fjalë apo shprehje së cilës i është dhënë një kuptim i vecantë në ndonjë pjesë të kushteve të përgjithshme, të formularit, apo shtojcave, do të mbajë të njëjtin kuptim kudo që mund të paraqitet.
2. Në rast se primi për këtë policë është llogaritur bazuar mbi informacionin e dhënë nga i siguruari, ky duhet të mbajë shënime të sakta që përmbajnë të gjitha detajet dhe brenda një kohe të arsyeshme të lejojë siguruesin për të kryer inspektimin e të dhënave. Pas përfundimit të çdo periudhe të policës, i siguruari duhet t'i japë siguruesit informacionin e saktë të përditësuar, në mënyrë që primi për periudhën në vijim të llogaritet saktë.
3. Siguruesi mund të kryejë inspektime ne ambientet e të siguruarit. Në rast të konstatimit të një defekti, apo rreziku të dukshëm, për të cilin i siguruari nuk merr masa të mënjëhershme për ta eliminuar, siguruesi mund t'i dërgojë të siguruarit një njoftim me shkrim nëpërmjet të cilit siguruesi heq përgjegjësinë e tij për dëmet që mund të rezultojnë më vonë nga ky defekt apo rrezik.
4. Në rast se i siguruari konstaton dicka që mund të ndikojë materialisht tek risku i siguruar, ai brenda shtatë ditësh njofton për këtë fakt siguruesin.
5. Shqyrtimi dhe plotësimi i duhur i termave, parashikimeve dhe kushteve, për sa kohë këto lidhen me dicka për t'u kryer apo përmbushur nga i siguruari dhe vërtetësia e të dhënave të tij në pyetësor (që përbën bazën e kësaj police dhe mbahet bashkë me të si pjesë e saj) do të jenë kusht paraprak i cdo përgjegjësie të siguruesit.

**X. Parashikime të veçanta**

1. Kufijtë minimalë të mbulimit në sigurim sipas seksionit IV të këtyre kushteve përcaktohen si më poshtë:

a. *Për cdo pikë me kapacitet më të lartë se 3,000 $m^3$*

(i) kufiri minimal i mbulimit në sigurim për çdo ngjarje - 100 milionë lekë

(ii) kufiri minimal agregat vjetor i mbulimit në sigurim - 200 milionë lekë

(iii) nënkufiri minimal i mbulimit për vdekjen dhe dëmtimet trupore të çdo personi të dëmtuar - 10 milionë lekë

(iv) pjesa e zbritshme për cdo ngjarje nuk mund të jetë më e madhe se 0,5 për mijë e kufirit të mbulimit në sigurim për çdo ngjarje, të përcaktuar në formularin e policës së sigurimit

b. *Për cdo pikë me kapacitet deri në 3,000 $m^3$ :*

(i) kufiri i mbulimit në sigurim për çdo ngjarje - 50 milionë lekë

(ii) kufiri agregat vjetor i mbulimit në sigurim - 100 milionë lekë

(iii) nënkufiri minimal i mbulimit për vdekjen dhe dëmtimet trupore te çdo personi të dëmtuar - 10 milionë lekë

(iv) pjesa e zbritshme për cdo ngjarje nuk mund të jetë më e madhe se 0,5 për mijë e kufirit të mbulimit në sigurim për çdo ngjarje, të përcaktuar në formularin e policës së sigurimit

2. Primi vjetor i sigurimit që do të përcaktohet në formularin e policës së sigurimit nuk mund të jetë më i ulët se 0.4% e kufirit të mbulimit në sigurim për cdo ngjarje të përcaktuar në formularin e policës. Vlerësimi i primit të sigurimit duhet të bazohet në pyetësorin e plotësuar nga i siguruari para nënshkrimit të policës.

**XI. Periudha e policës së sigurimit**

Data e fillimit dhe mbarimit të policës së sigurimit përcaktohet në formular.